




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KLINËS PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Klinës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Klinës (KK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Klinës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Klinës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

Çështjet që kanë ndikuar në konkluzionin e pajtueshmërisë janë si në vijim:

- A1 Komuna nuk ka arritur të plotësojë kërkesën ligjore në lidhje me verifikimin e 20% të objekteve komunale.
- A2 Komuna nuk i kishte respektuar kriteret e thirrjeve publike dhe kërkesat e Rregullores për Subvencionimin e OJQ-ve, me rastin e dhënies së subvenconeve.
- A3 Komuna nuk i ka trajtuar Llogaritë e Arkëtueshme në pajtim me kërkesat ligjore dhe kushtet e përcaktuara në kontrata dhe aktvendime.
- B1 Në 908 raste pagesat janë realizuar pas afatit ligjor të pagesave prej 30 ditësh.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Klinës.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Klinës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Klinës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Klinës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Klinës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, menaxhimin e kontratave, llogaritë e arkëtueshme, vonesat në pagesa, menaxhimin e subvencioneve si dhe menaxhimin e regjistrave të pasurive dhe inventarizimin, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja, dhe tetë (8) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A1 - Mangësi në inspektimin e objekteve komunale

**Gjetja** Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Neni 15, përcakton se Komuna çdo vit inspekton të paktën njëzet përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe për të ndihmuar në veprimtaritë inspektuese mund të angazhojë edhe inspektorë privat.

Komuna e Klinës kishte faturuar Tatimin në Pronë nga sistemi i Protax për 9,896 objekte. Komuna në vitin 2021 kishte arritur të bëjë inspektimin (verifikimin) e vetëm 612 objekteve apo rreth 6%.

Sipas Komunës, kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së stafit të mjaftueshëm për kryerjen e inspektimeve.

**Ndikimi** Mos arritja e inspektimit të 20% të objekteve mund të rezultojë në ngarkesë më të lartë apo të ulët tatimore për tatimpaguesit, me ç'rast njëra palë potencialisht është e dëmtuar.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja A2 - Shpallja Publike, dhënia e Subvencioneve, dhe vlerësimi në kundërshtim me kriteret e thirrjes publike dhe Rregulloren për Subvencionim të OJQ-ve

**Gjetja** Në Thirrjet Publike të datës 12.04.2021 dhe atë të datës 25.08.2021, disa prej kriterëve kanë qenë që: aplikuesit duhet të kenë kryera të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit; dëshmi që nuk kanë obligime ndaj ATK-së; të paraqesin prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale.

Ndërsa, Rregullorja e MF - Nr - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, përcakton se: thirrja duhet të jetë e hapur për së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë pune (Neni 12.1); Secili nga anëtarët e Komisionit Vlerësues, para vlerësimit nënshkruan deklaratën mbi paanshmërinë dhe konfidencialitetin (Neni 16.2); Komisioni Vlerësues mban procesverbal për gjithë procesin e vlerësimit të aplikacioneve që nga procesi i hapjes së aplikacioneve deri tek marrja e vendimit (Neni 16.6); aplikantët të cilët marrin më pak se pesëdhjetë (50) pikë nuk mund të përfitojë mbështetje financiare në asnjë rast (Neni 18).

Gjatë testimit të pesë lëndëve për qëllime të pajtueshmërisë me procedura (me vlerë të përbashkët 87,000€) kemi vërejtur se:

- Asnjëra nga lëndët e testuara nuk përmbante dëshmi/raporte mbi mbështetjen financiare paraprake, prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale,



ndërsa një përfitues që ka përfituar nga të dy thirrjet publike kishte edhe borxhe tatimore në ATK;

- Thirrja publike e datës 25.08.2021 ishte e hapur vetëm për shtatë ditë e që duhet të ishte 15 ditë; dhe
- Komisioni Vlerësues me anëtarë nuk kishte nënshkruar deklaratën mbi paanshmërinë dhe konfidencialitetin, nuk kishte mbajtur procesverbal, dhe nuk kishte përdorur formularin për vlerësimin e cilësisë së aplikacioneve (F15) për të përcaktuar se a kualifikohen aplikuesit për subvencion apo jo.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme që ka rezultuar edhe me mos respektim të kërkesave të Rregulloreve të aplikueshme dhe kriterëve të përcaktuara me thirrje publike.

#### **Ndikimi**

Mangësitë e listuara, përveç që janë në kundërshtim me Rregulloret e zbatueshme dhe e dëmtojnë konkurrencën, paraqesin edhe rrezik që fondet e dhëna të mos jepen për përfitueset meritore dhe për qëllimet e duhura.

#### **Rekomandimi A2**

Kryetari duhet të shtojë kontrollet për të siguruar se zyrtarët të cilët janë përfshirë në proceset e dhënies së subvencioneve të jenë të informuar mirë në lidhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të mos përsëriten gabimet e sipërpërmendura duke respektuar rregullat përkatëse për subvencionim.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A3 - Mos marrja e veprimeve ligjore për inkasimin e llogarive të arkëtueshme**

#### **Gjetja**

Neni 26 Ligji nr.06\_L-005 Për tatimin në pronën e paluajtshme përcakton se Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e 10€;

Po ashtu në Aktvendimet për ushtrimin e veprimtarisë afariste apo profesionale përcaktohet se pagesa e ngarkesës së caktuar bëhet në dy këste: Kësti i parë bëhet deri më 15.06 të vitit aktual, ndërsa Kësti i dytë bëhet deri më 15.12 të vitit aktual.

Më tutje, Neni 4 i kontratës për shfrytëzuesit e lokaleve me qira përcakton që "Shfrytëzuesi i lokalit detyrohet që dhënësit të lokalit t'i paguajë qiranë e aplikueshme deri me datën 05 të fillimit të muajit, për muajin në vijim", derisa neni 6 i kontratës për banesat sociale të lëshuara me qira përcakton se "Shfrytëzuesi i banesës duhet t'i kryejë detyrimet e nevojshme për qira në afat prej 15 ditëve pas pranimit të faturës".

Gjatë testimit të mostrave për tatimin në pronën e paluajtshme, për ushtrimin e veprimtarisë afariste, të shfrytëzuesve të lokaleve me qira, dhe mostrave të banesave me qira, kemi gjetur se në pesë mostra të tatimit në pronë me vlerë prej 58,863€, në nëntë mostra për ushtrimin e veprimtarisë afariste me vlerë prej 23,190€, në shtatë (7) mostra të shfrytëzuesve të lokaleve me qira, dhe në 10 mostra të qirave të banesave me vlerë prej 24,583€, Komuna nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ligjor për mbledhjen e këtyre mjeteve nga këta borxhlinj edhe pse të njëjtit nuk kanë kryer asnjë pagesë gjatë vitit 2021.

E gjithë kjo ka ndodhur si rezultat i mos funksionimit të kontrollit të brendshëm, përkatësisht neglizhencës së zyrtarëve të Komunës për t'u

angazhuar në mbledhjen e këtyre borxheve që datojnë nga viti 2004 e tutje.

**Ndikimi** Mungesa e gatishmërisë së zyrtarëve për të mbledhur të hyrat me kohë, paraqet rrezik që me kalimin e kohës, mbledhja e disa prej këtyre të arkëtueshmeve do të bëhet e pamundur, dhe kështu edhe do të rrezikohen projektet komunale të planifikuara nga financimi i këtyre fondeve.

**Rekomandimi A3** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se zyrtarët në departamentet përkatëse do të ndërmarrin të gjitha masat në pajtim me kriteret e lartpërmendura, në mënyrë që fillimisht të mblidhen të hyrat siç janë paraparë, dhe të shikojë mundësitë ligjore për shlyerjen e borxheve të vjetra.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B1 - Vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzimet shtesë të procedurave përmbartimore**

**Gjetja** Sipas nenit 39.1 të Ligjit Nr.03/L-048 për LMFPP, Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore do të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrat të prerë nga gjykata/përmbartuesi.

Nga analiza e data bazës së furnitorëve kemi vërejtur se komuna gjatë vitit 2021 kishte kryer pagesa në vlerë prej 611,275€ apo 908 raste të pagesave të cilat e kanë tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditësh. Vonesat variojnë nga një (1) muaj deri në mbi tre (3) vite.

Për dy (2) pagesat e realizuara nga Thesari për paga jubilarë dhe përcjellëse të stafit arsimor, në bazë të vendime gjyqësore/përmbartimore në vlerë 532,010€, borxhi kryesor ishte 421,794€ ndërsa 110,216€ ishin për shpenzime procedurale të gjykatës/përmbartimit.

Mos kryerja e obligimeve për paga jubilarë dhe përcjellëse për stafin ka ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve, derisa vonesat në pagesën e faturave për shkak të neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës për kryerjen e pagesave.

**Ndikimi** Mos pagesa me kohë e obligimeve dhe faturave, e ekspozon Komunën ndaj padive nga punonjësit dhe nga Operatorët Ekonomik, duke shkaktuar kosto shtesë për procedura të përmbartimit dhe gjykatës, kjo po ashtu ndikon në planin e shpenzimeve dhe pamundëson arritjen e objektivave të përcaktuara.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat dhe obligimet të paguhet brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbartimit.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Klinës në vitin 2021 ishin në vlerë 1,365,338€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Poashtu Komuna ka pranuar të hyra të realizuara nga niveli qendror, respektivisht nga gjjobat e gjykatave 276,797€ dhe nga gjjobat e trafikut shumën prej 23,640€.

#### Çështja B2 - Mangësi në bazën e të dhënave për tatimin në pronë

##### Gjetja

Ligji Nr. 06/L-005 Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Neni 11, thekson që personi fizik i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej pesëmbëdhjetë mijë (15,000) Euro nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Personi fizik i cili ka në pronësi apo posedim dy (2) ose më shumë njësi rezidenciale të objekteve, mund të deklarojë në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni, vetëm një prej këtyre objekteve si vendbanimin e tij parësor, pa marrë parasysh faktin që njësitë e objekteve mund të ndodhen në komuna të ndryshme.

Gjatë analizës së Bazës së dhënave të tatimit në pronë, janë identifikuar dhjetë (10) raste ku tatimpaguesit janë përfitues në dy vendbanime parësore që është në kundërshtim me kërkesat ligjore. Për më tepër, situata është më serioze sepse 389 tatimpagues të evidentuar në këtë bazë të të dhënave nuk kanë të prezantuar numrat personal, e të cilët potencialisht mund të jenë përfitues të disahershëm nga zbritja e lejuar ligjore.

Kjo ka ndodhur si rezultat i pakujdesisë së zyrtarëve dhe mangësive të sistemit që lejon përfitimin e disahershëm të tatimpaguesve dhe të futjes së tyre në sistem pa numër identifikues.

##### Ndikimi

Zbatimi i zbritjeve të lejuara për tatimpaguesit pa numër personal dhe pa u deklaruar se vendbanimi i tatimpaguesit shërben si vendbanim parësor, mund të rezultojë me përlogaritje të pasakta të zbritjeve për tatimin në pronë dhe rrjedhimisht më pak të hyra për Komunën.

##### Rekomandimi B2

Kryetari dhe vartësit e tij duhet të ndërmarrin veprime të menjëhershme për identifikimin e të gjithë përfituesve të disahershëm të zbritjes së vendbanimit parësor, t'i korrigjojnë të dhënat në sistem dhe t'i ndërmarrin të gjitha masat ligjore për eliminimin e këtij problemi.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,182,272€, prej tyre në 2021 ishin shpenzuar 2,698,527€. Ato kanë të bëjnë me ndërtim të rrugëve, kanalizimeve, ndriqimit publik, objekteve sportive, blerje të autoambulancave, renovime etj.

### Çështja B3 - Investime publike në parcela të pa shpronësuara

**Gjetja** Neni 4 pika 2.4.3.1 të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e pronës së paluajtshme, përcakton se “Organi Shpronësues i Komunës mund të bëjë shpronësimin e pronës së paluajtshme vetëm nëse ndërlidhet me rrugët komunale (rrugët të cilat shtrihen tërësisht brenda komunës) të cilat ofrojnë shërbime të transportit për publikun”.

Gjatë testimit të projekteve kapitale të iniciuara në vitin 2021 nga Komuna, në pesë prej tyre: Asfaltimin e rrugëve Zabërgjë, Gllarevë, Rixhevë, Stapanicë; Asfaltimin e rrugëve Shtupel-Kërrnicë; Asfaltimin e rrugës në fshatin Dobërdol; Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë dhe Dresnik; Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës dhe infrastrukturës nëntokësore në fshatrat Jashanicë e Resnik, Komuna kishte marrë pëlqim nga pronarët e tokave për të realizuar investimin, por nuk kishte ndërmarrë asnjë procedurë ligjore që pronat në të cilat po kryhen investimet të kthehen në pasuri të komunës sikur edhe parashihet me ligjet në fuqi. Për më tepër, asnjë masë nuk ishte ndërmarrë as në lidhje me shpronësimin e rrugëve në fshatrat Dollovë, Grabanicë, Dush dhe Jellovë, që kanë qenë gjetje në raportin e vitit të kaluar.

Sipas zyrtarëve të komunës nëse do të zhvilloheshin procedura të shpronësimit do të rriteshin kostot për komunën dhe në këtë mënyrë do të zvogëlohej mundësia financiare e komunës për të investuar në projekte kapitale.

**Ndikimi** Realizimi i projekteve të tilla rrit rrezikun që vlera investive e tyre të mos i dedikohet interesave të gjëra të qytetarëve dhe se Komuna rrezikon të përballet me padi në të ardhmen nga pronarët e parcelave, ku përveç kompensimit të shpronësimit do të shkaktohen edhe shpenzimet tjera shtesë.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të sigurojë që është ndarë buxhet për shpronësim të parcelave dhe çështjet pronësore të trajtohen në bazë të dispozitave ligjore para inicimit të tenderimit për ekzekutim të projekteve kapitale - ndërtim/zgjerim të rrugëve dhe infrastrukturë tjetër.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B4 - Vonesa në realizimin e kontratave dhe realizimi i kontratave me siguri të ekzekutimit të skaduar****Gjetja**

Sipas nenit 81 të LPP nr.05/L-068, si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, pikat 61.6,61.19 dhe 61.20 përcaktohet që: Menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se OE realizon kontratën në përputhje me afatet termet dhe kushtet tjera të specifikuara në kontratë. Ndërsa, pika 30, përcakton se Siguria e ekzekutimit është paraparë të mbështetë përmbushjen e kontratës në rastet kur ekziston rreziku për shkeljen e kontratës që do të shkaktonte dëme substanciale dhe shpenzime të mëtutjeshme për Autoritetin Kontraktues.

Në pesë kontrata të investimeve kapitale punët nuk janë realizuar në pajtim me afatet/planet dinamike të përcaktuara në kontratat përkatëse, dhe nuk kanë qenë të mbuluara me afate valide të sigurisë së ekzekutimit:

Te kontrata “Asfaltimi i Rrugës Aqarevë-Siqevë me vlerë 384,124€ të nënshkruar me 23.07.2019, është paraparë përfundimi i punëve brenda 119 ditëve të punës, me Siguri të Ekzekutimit valide prej 149 ditëve të punës nga data e nënshkrimit, (e cila nuk ishte rinovuar më) ndërsa punët janë pranuar me 31.12.2020.

Te kontrata “Asfaltimi i Rrugës Bokshiq” me vlerë 43,344€ të nënshkruar me 09.09.2020, është paraparë që punët të përfundojnë brenda 56 ditëve të punës dhe me Siguri të Ekzekutimit valide prej 86 ditëve të punës nga data e nënshkrimit (e cila nuk ishte rinovuar më) ndërsa punët janë pranuar me 01.07.2021.

Te kontrata “Asfaltimi i Rrugëve Lokale në Gremnik” me vlerë 78,399€ të nënshkruar me 26.10.2020, është paraparë që punët të përfundojnë brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe Siguria e Ekzekutimit ishte valide deri me 25.12.2020 (e cila nuk ishte rinovuar më) ndërsa punët janë pranuar me 16.06.2021.

Te kontrata “Ndërtimi i Rrugës dhe Trotuareve dhe Infrastrukturës Nëntokësore në Qytetin e Klinës” me vlerë 159,532€ të nënshkruar me 21.10.2020, është paraparë që punët të përfundojnë brenda 99 ditëve të punës nga nënshkrimi i kontratës dhe Siguria e Ekzekutimit ishte valide për 129 ditë të punës nga data e nënshkrimit (e cila nuk ishte rinovuar më) ndërsa punët janë pranuar me 20.04.2021.

Te kontrata “Ndërtimi i Stacionit të Autobusëve-Faza e Parë” me vlerë 67,588€ të nënshkruar me 19.01.2021, është paraparë që punët të përfundojnë brenda 120 ditëve kalendarike, dhe me Siguri të Ekzekutimit valide deri me 19.06.2021 (e cila nuk ishte rinovuar më) ndërsa punët janë pranuar me 23.09.2021.

Shkak i vonesave në realizimin e këtyre projekteve ishte mos-koordinimi i zyrës së prokurimit me drejtoritë përkatëse për përcaktimin e planeve adekuate dinamike, ndërsa mos-vazhdimi i sigurisë së ekzekutimit ka ndodhur për shkak të neglizhencës së menaxherëve të kontratave.

**Ndikimi**

Dështimi për të realizuar kontratat përbrenda planeve dinamike të përcaktuara të kontratave dhe përbrenda afateve të sigurisë të ekzekutimit, rrezikojnë realizimin e projekteve kapitale dhe objektivave komunale.

**Rekomandimi B4** Kryetari duhet të sigurojë se drejtoritë përkatëse para nënshkrimit të kontratës të dakordohen në lidhje me vendosjen e planit dinamik të përfundimit të punëve, në mënyrë që të mos ketë vonesa, ndërsa në rastet kur tejkalohej plani dinamik/mbulesa me siguri të ekzekutimit, të kërkohej rinovimi i sigurisë së ekzekutimit nga Operatori Ekonomik.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A4 - Mos-nënshkrimi i planit të menaxhimit të kontratës nga palët kontraktuese**

**Gjetja** Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, pika 61.8 përcaktojnë se plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës, kjo do të dokumentohet me nënshkrimet e të dyja palëve, përkatësisht, menaxherit të kontratës nga ana e Autoritetit Kontraktues dhe menaxherit të kontratës nga ana e Operatorit Ekonomik.

Gjatë testimit të nëntë (9) lëndëve për qëllime të pajtueshmërisë me procedura kemi gjetur se kishte mangësi me planin e menaxhimit të kontratës. Në tre (3) raste plani i menaxhimit të kontratës nuk është nënshkruar fare, ndërsa në gjashtë (6) raste plani është nënshkruar vetëm nga operatori Ekonomik e jo edhe nga Autoriteti Kontraktues.

Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së menaxherëve të kontratave, të cilët nuk kanë përfillur kërkesën e rregullave që t'i nënshkruajnë planet e menaxhimit të kontratave.

**Ndikimi** Mos-nënshkrimi i planeve përkatëse të menaxhimit të kontratave nga palët kontraktuese, shfaqë mungesë serioziteti nga zyrtarët komunal dhe nuk konfirmon që plani i menaxhimit në të vërtetë është dakorduar nga të dyja palët, dhe kjo ndikon që të ndodhin vonesa në ekzekutimin e punëve.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e emërimit të menaxherëve të kontratave, menjëherë pas nënshkrimit të kontratave, të nëshkruhet plani për menaxhimin e kontratave nga të dyja palët, në pajtim me kërkesat ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.2.3 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

Në këtë pjesë janë paraqitur çështjet e përbashkëta që lidhen me kategorinë e mallrave dhe shërbimeve si dhe Investimeve kapitale.

#### Çështja B5 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

##### Gjetja

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Në dy (2) raste janë kryer pagesa në vlerë 16,000€ nga Investimet kapitale për shpenzimet që i takonin natyrës së Subvencioneve dhe Transfereve, ngase pagesat janë kryer në kuadër të projektit "Fuqizimi socio-ekonomik i Ballkanit Përëndimor", i cili ka karakter të përkrahjes dhe mbështetjes së zhvillimit të ndërmarrësisë, mbështetjes së ndërmarrjeve të vogla përmes trajnimeve etj. Derisa në tri (3) raste tjera, janë paguar 19,309€ nga Investimet Kapitale për shpenzime të cilat i takojnë natyrës së mallrave dhe shërbimeve ( inventar për shkolla në vlerë 4,930€, pajisje kabinetike në vlerë 8,654€ dhe pajisje mjekësore në vlerë 5,725€, vlera individuale e të cilave ishte shumë më e vogël se 1,000€).

Kjo ka ndodhur si pasojë e planifikimit të gabuar të shpenzimeve gjatë hartimit të buxhetit nga ana e Komunës dhe aprovimit të buxhetit nga Ministria e Financave.

##### Ndikimi

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ndikon në mbivlerësim/nënvlerësim të shpenzimeve në kategori të ndryshme si dhe prezantim jo të saktë të shpenzimeve në PFV.

##### Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.4 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e pasurive kapitale e paraqitur në PFV, ishte 69,539,313€, pasurive jokatitale 700,275€, si dhe e stoqeve 378€.

### Çështja B6 - Mangësi në procesin e inventarizimit të pasurive

**Gjetja** Neni 19, pika 4.7, i Rregullores MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore përcakton që inventarizimi i pasurisë duhet të kryhet para përfundimit të PFV-ve. Derisa sipas pikës 6 të nenit 19 të kësaj rregulloreje, të gjitha ndryshimet në numrin ose vlerën e pasurive të cilat përcaktohen pas inventarizimit duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive dhe në regjistrin kontabël.

Ne kemi vërejtur se nuk është bërë harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrin e pasurive, pasi që nuk është bërë një raport përmbledhës për të gjitha pasuritë e Komunës. Në vend të kësaj Komuna kishte përfunduar një raport për inventarizimin e pasurive të sektorit të arsimit dhe një raport për inventarizimin e pasurive të administratës. Në këto raporte janë përfshirë vetëm pasuritë jo kapitale, pra nën 1,000€. Si i tillë inventarizimi i shte i mangët.

Kjo kishte ndodhur për shkak të neglizhencës së stafit të angazhuar në procesin e inventarizimit, për të zbatuar detyrat që rrjedhin nga vendimi për caktimin e tyre në këtë komision.

**Ndikimi** Mangësitë në procesin e inventarizimit të pasurive në fundvit, ndikojnë në mungesën e informatave të sakta për menaxhmentit në lidhje me gjendjen aktuale të pasurive. Poashtu kjo mund të ndikojë në shpалosjen e informatave jo të sakta në PFV për shkak të mos krahasimit të gjendjes aktuale të pasurive me regjistrat e OB-së.

**Rekomandimi B6** Kryetari duhet të sigurojë se puna e komisionit të inventarizimit është kryer me përgjegjësi të plotë dhe para përpilimit të PFV-ve për vitin 2022. Implementimi i këtij procesi duhet të reflektojë me krahasimin ndërmjet inventarizimit dhe gjendjes së pasurisë të mbajtur në regjistrat kontabël.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja B7 - Mangësi në evidentimin e pasurive jo financiare

**Gjetja** Rregullorja 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive të Organizatave buxhetore, përcakton mënyrën e regjistrimit, mirëmbajtjes së regjistrave të pasurive, zhvlerësimin, procesin e inventarizimit etj.

Regjistri i pasurive kapitale ishte mbivlerësuar për 35,000€ për shkak se 13 automjete të vjetra, edhe pse është dashur të zhvlerësohen komplet, nuk janë zhvlerësuar fare. Duhet të potencohet se tri (3) nga këto vetura me vlerë kontabël prej 7,000€, së bashku me gjashtë (6) automjete tjera me vlerë kontabël zero, ishin shitur përmes ankandit publik (disa në vitin 2013 dhe disa në 2017), por ato akoma nuk janë hequr nga regjistri i pasurive.

Përveq kësaj, së paku 5 blerje/fatura të pasurive jo kapitale me vlerë të përbashkët prej 11,248€ nuk janë regjistruar në sistemin e-pasuria.



Kjo ka ndodhur si pasojë e përpjekjeve të pa mjaftueshme për azhurnimin e regjistrave dhe si dhe bashkëpunimi i mangët i komisioneve të tjetërsimit të pasurive me zyrtarin e pasurive.

**Ndikimi**

Regjistri jo i plotë i pasurive, ndikon në mungesën e informatave të sakta dhe të plota për pasuritë si dhe raportim jo të drejtë të tyre. Po ashtu mos evidentimi i pasurive në regjistra rrit rrezikun e humbjes apo tjetërsimit të pasurive.

**Rekomandimi B7**

Kryetari duhet të sigurojë që zyrtarët përgjegjës bëjnë azhurnimin e plotë të regjistrit të pasurive kapitale, si dhe evidentimin e pasurive jo kapitale në sistemin e-pasuria, në mënyrë që informatat e shpalosura për pasuritë në PFV të jenë të sakta dhe të plota.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2.5 Të arkëtueshmet

Komuna e Klinës në PFV-të e vitit 2021 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 2,893,036€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë, licencat për biznes, qiraja për lokale dhe banesa, shfrytëzimi i pronës publike etj.

### Çështja B8 - Rritja e vazhdueshme e llogarive të arkëtueshme

<b>Gjetja</b>	<p>Komuna nuk ka arritur të përgatis një plan operativ për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme siç ishte rekomanduar nga Zyra Kombëtare e Auditimit vitin e kaluar, dhe nuk ka ndërmarrë veprimet e kërkuara sipas legjislacionit.</p> <p>Llogaritë e arkëtueshme krahasuar me vitin e kaluar janë rritur për 268,258€ (apo 10%). Rritja më e madhe ka ndodhur te tatimi në pronë si dhe tek pronat e dhëna me qira (lokale dhe banesa).</p> <p>Shkaqet e rritjes së të Arkëtueshmeve janë veprimet e pamjaftueshme të komunës, që përmes organeve të drejtësisë të zvogëlojë borxhin e pa mbledhur nga klientët.</p>
<b>Ndikimi</b>	<p>Mos arkëtimi i të hyrave ndikon në dëmtimin e buxhetit të komunës. Mungesa e kontrollit dhe mos veprimi i komunës pamundëson arkëtimin dhe rritë rrezikun e vjetërsimit të llogarive të arkëtueshme.</p>
<b>Rekomandimi B8</b>	<p>Kryetari duhet të sigurojë një plan veprimi për mbledhjen e borxheve. Fillimisht duhet të intensifikohen aktivitetet përfshirë veprimet ligjore përmes përmbauesve për ulje të llogarive të arkëtueshme.</p>

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>4</sup>	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>10,658,263</b>	<b>11,634,795</b>	<b>11,134,682</b>	<b>10,780,214</b>	<b>10,105,744</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	9,827,826	10,199,260	10,065,557	9,918,994	8,907,482
Financimi përmes huamarrjes	0	23,911	23,911	73,710	98,650
Të bartura nga viti i kaluar	0	554,975	482,004	323,013	266,348
Të hyrat vetanake	830,437	830,437	542,080	458,649	815,273
Donacionet vendore	0	21,212	16,130	5,848	2,387
Donacionet e jashtme	0	5,000	5,000	0	15,603

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 976,532€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së grantit qeveritar sipas vendimeve të qeverisë në vlerë prej 371,434€, të hyrave të bartura 554,975€, donacioneve 26,212€ dhe financimi nga huamarrja 23,911€.

Në vitin 2021 Komuna e Klinës ka shpenzuar 96% të buxhetit përfundimtar në 2021 ose 11,134,682€, me një përmirësim për 4% në krahasim me vitin 2020. Realizimi i buxhetit është në nivel të knaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>10,658,263</b>	<b>11,634,795</b>	<b>11,134,682</b>	<b>10,780,214</b>	<b>10,105,744</b>
Pagat dhe mëditjet	6,297,124	6,700,218	6,700,218	6,288,923	5,953,094
Mallrat dhe shërbimet	1,211,000	1,222,560	1,211,429	1,571,273	1,025,596
Komunalitë	180,000	180,000	179,399	139,089	168,147
Subvencionet dhe transferet	305,000	349,745	345,109	211,598	114,748
Investimet Kapitale	2,665,140	3,182,272	2,698,527	2,569,331	2,844,159

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje kishte rritje në krahasim me buxhetin fillestar për 403,094€. Kjo rritje ishte si rezultat i vendimeve të Qeverisë, dhe të: nga granti qeveritar janë shtuar 365,184€, nga huamarrja 23,910€ dhe nga të hyrat e bartura 14,000€. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 100%.
- Buxheti final për Mallra dhe Shërbime në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 11,560€. Rritja ishte si rezultat i donacioneve në vlerë 5,000€ dhe nga të hyrat e bartura 7,310€. Derisa kishte një zvogëlim nga granti qeveritar për 750€ si pasojë e bartjes së inspektorëve nga komuna në Agjencionin e Ushqimit dhe Veterinës. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 99%.
- Buxheti final për shërbime komunale ishte i njëjtë me buxhetin fillestar derisa realizimi në këtë kategori ishte 100%.
- Buxheti final për Subvencione dhe Transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 44,745€, si rezultat i bartjes së donacioneve 12,745€ dhe me vendim të Qeverisë 32,000€.
- Buxheti final për Investime Kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 517,132€. Fillimisht kishte rritje të buxhetit nga të hyrat vetanake në vlerë 533,665€, dhe nga donacionet 8,467€, derisa kishte një zvogëllim të grantit qeveritar me vendim të qeverisë në vlerë prej 25,000€. Realizimi në këtë kategori në fund të vitit ishte 85%.
- Mjetet e shpenzuara gjatë vitit 2021 për rimëkëmbjen ekonomike ishin 206,666€, prej tyre për shtesa në paga janë shpenzuar 174,666€ dhe 32,000€ për subvencione.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Klinës në vitin 2021 ishin në vlerë 1,365,338€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Poashtu Komuna ka pranuar të hyra të realizuara nga niveli qendror, respektivisht nga gjambat e gjykatave 276,797€ dhe nga gjambat e trafikut shumë prej 23,640€.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>830,437</b>	<b>830,437</b>	<b>1,365,338</b>	<b>778,587</b>	<b>941,015</b>
Të hyrat tatimore	425,320	425,320	488,481	303,263	372,427
Të hyrat jo tatimore	405,117	405,117	876,857	475,324	568,330
Të hyrat tjera	0	0			258

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e Komunës së Klinës të vitit 2020 ka rezultuar në 18 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Raporti gjithashtu është diskutuar edhe në mbledhje të Kuvendit Komunal.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, nëntë (9) rekomandime janë zbatuar, tetë (8) nuk janë zbatuar dhe një (1) rekomandim është mbyllur. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj se të gjitha pagesat realizohen pas nënshkrimit nga zyrtarët e autorizuar, po ashtu, duhet të siguroj që për çdo zyrtarë të autorizuar të kenë zyrtarë alternativë, në rast të mungesës së tyre.	Janë ndërmarrë veprimet për zbatimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj se qiramarrësit marrin faturën për qira nga komuna si dhe të gjithë qiramarrësit të kenë kontrata. Po ashtu, për qiramarrësit që neglizhojnë ta paguajnë qiranë të ndërmerr veprime të menjëhershme për largimin e tyre nga pronat, lokalet dhe banesat komunale.	Ky rekomandim rekomandim është mbyllur pasi që për këtë çështje kemi dhënë një rekomandim të ri (shih rekomandimin A3).	Nuk është i aplikueshëm më

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të bëjë një rishikim të zbatimit të kësaj kontrate për të siguruar se ofrimi i shërbimeve po zbatohet sipas specifikimeve të kontraktuara. Në raportet mujore të përgatitura nga OE duhet të përshkruhet në detaj secili shërbim i ofruar dhe se pagesat duhet të bëhen vetëm pasi të jetë marrë siguria/dëshmitë se shërbimet janë pranuar. Po ashtu, për rastet e pagesave në mungesë të dëshmimeve se janë ofruar shërbimet, duhet të shqyrtohet mundësia e kthimit të mjeteve në buxhetin e komunës. Kryetari duhet të sigurohet që të mos bëhen devijime dhe rritje indikativë në kriteret e kontratës në kundërshtim me legjislacionin.	Janë ndërmarrë veprimet për zbatimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar
4.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi. Si rezultat edhe gjatë vitit 2021 kishte keqklasifikim të shpenzimeve.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë se dosjet e tatimpaguesve janë kompletuar bazuar në kërkesat e sistemit Protax.	Dosjet e tatimpaguesve janë ende të pa kompletuara.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet paraprakisht të sigurohet se ka mundësi për rritje të stafit si dhe buxhet të lejuar me Ligjin e Buxhetit, me qëllim që kompensimi i këtij stafi të angazhuar të jetë i rregullt. Për shkak të kufizimeve, komuna duhet të parashtroj kërkesa të arsyeshme dhe nxis rritjen e numrit të stafit pranë organeve relevante, në të kundërtën kjo formë e pageses nuk është e rregullt dhe nuk duhet të vazhdojë	Janë ndërmarrë veprimet për zbatimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar
7.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që komisionet përkatëse për pranimin e mallrave/furnizimeve janë caktuar me kohë dhe se të gjitha pagesat bëhen bazuar në raportet e pranimin sipas rregullave të përcaktuara.	Janë ndërmarrë veprimet për zbatimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar
8.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari i komunës duhet të ndërmarrë masa që asnjë pagese të mos kryhet pa kontratë valide, po ashtu duhet të sigurojë komunikim efektiv në mes njërive kërkuese dhe zyrës së prokurimit në mënyrë që procedurat e prokurimit të zhvillohen me kohë.	Janë ndërmarrë veprimet për zbatimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar

9.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj përmes komisionit të vlerësimit se përfituesit e subvencioneve gjatë aplikimit kanë shpalosur në detaje të gjitha kërkesat në Formularin 10.	Janë ndërmarrë veprimet për zbatimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar
10.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të siguroj se, drejtoritë përkatëse përgatisin plan vjetor për subvencionim të OJQ-ve, si dhe, të siguroj se të gjithë përfituesit raportojnë në mënyrë të rregullt lidhur me implementimin/realizimin e projekteve, dhe për të gjithë ata që nuk raportojnë të marre vendim që mos të jenë përfitues të subvencioneve në thirrjet publike pasuese.	Komuna ka dërguar Planin Vjetor për financimin e OJQ në ZKM.	I zbatuar
11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se përcaktimi i saktë i nevojave dhe specifikimi i punëve duhet të përgatitet dhe projektohet para fillimit të tenderimit dhe në monitorimin e kontratave si organ mbikëqyrës, të përfshihet stafi kompetent që janë të njoftuar me përgjegjësit e përcaktuar me LPP. Nëse paraqitet nevoja për ndryshim të termeve dhe kushteve të kontratës, organi mbikëqyrës duhet të inicioj dhe arsyetoj pranë zyrës së prokurimit këto ndryshime dhe të marrin aprovimet nga nivelet relevante-ZKA.	Janë ndërmarrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar
12.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që është ndarë buxhet për shpronësim të parcelave dhe çështjet pronësore të trajtohen në bazë të dispozitave ligjore para inicimit të tenderimit për ekzekutim të projekteve kapitale - ndërtim/zgjerim të rrugëve dhe infrastrukturë tjetër.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
13.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se raportet e menaxherëve të kontratave ofrojnë informata të mjaftueshme dhe në kohë rreth ecurisë së implementimit të kontratave. Po ashtu, duhet të shtohen masat e kontrollit dhe në rastet kur ka vonesa të pa arsyetuara të aplikohen penalet për ditët në vonesë	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin
14.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë hartimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare. Po ashtu, kryetari duhet të siguroj funksionalizimin e depos që të mundësohet mbajtja e evidencave të sakta për gjendjen e stoqeve në çdo kohë.	Janë ndërmarrë veprimet për zbatimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar
15.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se, zyrtari i pasurisë bën regjistrimin e plotë të pasurisë jo financiare dhe mirëmban regjistrat e pasurisë që disponon komuna.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin



16.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se puna e komisionit të inventarizimit dhe komisionit të vlerësimit është kryer me përgjegjësi të plot dhe para përpilimit të PFV për vitin 2021. Implementimi i këtij procesi duhet të reflektojë me krahasimin ndërmjet inventarizimit dhe gjendjes së pasurisë të mbajtur në regjistrat kontabël.	Nuk është hartuar raporti përmbledhës i inventarizimit para përgatitjes së PFV-ve.	Nuk ka filluar zbatimi
17.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj një plan veprimi për mbledhjen e borxheve. Fillimisht duhet të intensifikohen aktivitetet përfshirë edhe veprimet ligjore përmes përmbauesve për ulje të llogarive të arkëtueshme.	Nuk janë ndermarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimi
18.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të ngritë kontrolle shtesë për tu siguruar se të gjitha faturat e pranuar paguhen brenda afatit të paraparë ligjor me qëllim të menaxhimit të obligimeve të papaguara.	Nuk janë ndermarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Bujar Bajraktari, Udhëheqës i ekipit




Gazmend Namani, Anëtar i ekipit




Edon Kabashi, Anëtar i ekipit



Fatbardha Jashari, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVO	KOMUNA E KLINËS MUNICIPALITY OF KLINA OPŠTINA KLINA	
<a href="http://www.komuna-klina.org">www.komuna-klina.org</a>			
<b>LETËR E KONFIRMIMIT</b>			
Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve			
Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit			
Të nderuar,			
Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:			
<ul style="list-style-type: none"><li>• kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Klinës, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raport");</li><li>• pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe</li><li>• brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.</li></ul>			
Z. Zenun Elezaj,			
Kryetar i Komunës së Klinës,			
Data: 08/Qershor,2022, Klinë,			

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>5</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>6</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.